



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 12/15

Prishtinë, më 24.3.2015, ora 12:45

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjoni, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, Bojan Mitić dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Semra Qitaku - U.D Drejtor në Departamentin Makroekonomik në MF, Lulzim Rafuna-Drejtor i Doganave të Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Lumnije Murati-Udhëheqëse e Divizionit-ZPRK, Pranvera Musa-Gazetare-Kosova Sot.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstaton se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**

Kryetari – pasi që qeveria ka dërguar një vendim për ndryshimin e normave të akcizës, e kam thirrur mbledhjen e komisionit, që të bëjmë vlerësimin ashtu siç e parasheh ligji, që vendimi hyn në fuqi pas konsultimit me Komisionin. Arsyeja pse është thirrur mbledhje urgjente, është që vendimi të mund të hyjë në fuqi menjëherë dhe mos të lejohen të krijohen probleme bizneseve, pastaj të kenë problem edhe doganat dhe administrata tatimore, si rezultat i informatës për këto ndryshime.

Avdullah Hot - sqaroi propozimin- vendimin e qeverisë për ndryshimin e normës së akcizës në disa produkte. Është hequr kufiri për vjetërsinë e veturave që ka qenë prej 13 vjetësh dhe kemi përcaktuar shumën e akcizës sipas viteve të amortizimit dhe fuqisë motorike. Heqja e këtij kufizimi, duhet të përcillet me kontrollin teknik të regjistrimit të veturave që çështjet e lirimi të gazrave të jenë në përputhje me direktivat evropiane. Është propozuar vendosja e normave të tatimit të akcizës në shumë prej 0.25€ cent për litër në vajra të rënda për ngrohje me një përmbajtje sulfurike më tepër se 0.1% ndaj peshës por jo me tepër se 1% ndaj peshës. Për cigare është propozuar që rritja të jetë nga 32 € në 35 €. Për pijet alkoolike 800€ për hektolitër, ndërkaq është propozuar lirimi i detyrimit në akcizë për alkoolin etilik për përdorim medicinal. Lidhur me akcizën me duhan, pijet alkoolike, arsyeshmëria që është dhënë prej departamenteve fiskale e ekonomike dhe në konsultim me ministrit e tjera, janë të natyrës ruajtjes së shëndetit publik dhe normalisht që ndikojnë edhe në të hyrat buxhetore, pa prekur standardin jetësor të njerëzve. Sipas direktivës së BE-së, minimumi i akcizës së aplikueshme në duhan duhet të jetë 90 euro.

Lulzim Rafuna – sa i përket vajit, ai quhet vaj solar dhe përdoret për procesin e ngrohjes dhe nuk është i përzier me dizell. Në momentin që përdoret për prodhim është i liruar nga akciza. Ne e kemi një praktik, ku të gjithë prodhuesit që e përdorin sistemin e gasit, aplikojnë pranë doganës për kthimin e tatimit të akcizë për gas, duke e dëshmuar me kupon fiskal. Të njëjtin sistem do ta përdorim edhe te ky vaj solar dhe na ia kthejmë shumën e akcizës dhe dallimin e TVSH-së.

Safete Hadergjonaj – jemi lajmëruar pak me vonesë për mbledhjen dhe do të ishte e nevojshme që të paktën ta kemi në formë elektronike materialin para takimit, sepse është vështirë tani me analizu dhe me marrë vendim. Çdo lëvizje që ka të bëjë me akcizat është çështje e ndishme dhe duhet bërë analizë, dhe unë nuk dyshoj që ju në ministri dhe bashkëpunim me doganën, se nuk i keni bërë ato analiza, por jo gjithmonë gjërat po shkojnë ashtu siç duhet. Ne kemi pasur diskutime të mëdha, kur e kemi rritur afatin për importin e makinave në 13 vite, dhe tash është propozuar të hiqet një kufizim i tillë, dhe në atë kohë kemi pasur vërshime të kërkesave nga personat të caktuar, që neve na nevojiten mjete e transportit dhe le të kemi afat me të gjatë. Mirëpo, në anën tjetër kemi pasur reagime të ambientalistëve, e të tjerëve, por edhe nga përvoja ime që udhëtojë çdo ditë, dhe nganjëherë e ke të mundimshme me ec rrugës nga gasi që lëshojnë makinat e vjetra. Për momentin, unë nuk mund të them se decidimisht jam kundër propozimit për rritjen e tatimit të akcizës dhe përcaktimit të kritereve, mirëpo është mirë mos të marrim vendime të nxitura dhe të kemi kohë për analiza më të kujdesshme para se të japim qëndrimin tonë.

Avdullah Hoti – sa i përket veturave, akciza paguhet me rastin e regjistrimit të parë të veturës, përndryshe në Kosovë ka vetura që pas 15 vjetëve e regjistrohen vazhdimisht. Janë kontrollat teknike që vërtetojnë se a i përmbushin kriteret që kërkohen për këto vetura.

Kryetari - kjo ka të bëjë vetëm me vetura personale, po çfarë me ato që janë të liruara nga dogana, pra pyetja ime është a ka vetura të liruara nga dogana?

Lulzim Rafuna - sqaroi se ka vetura të liruara nga dogana dhe janë për raste të caktuara, si për misionet diplomatike, kategoria e invalidëve të luftë, personat me nevojë të veçanta, për organizatat jo-qeveritare. Ndërsa këtu po flasim për veturat e dizajnuara për 5 persona, janë vetura të udhëtarëve jo mjete të punës. Me këtë propozim është një politik jo e favorshme për me u importu veturat e të vjetra, për arsye se, sa më e vjetër vetura, akciza shkon duke u rritur dhe rritja është mjaftë e lartë dhe kjo nuk e stimulon importimin e veturave të vjetra. Është quajtur diskriminues vendosjes e kufizimit, pasi që vendet e rajonit nuk kanë kufizime të tilla. Një veturë nuk mundet me u doganue pa e poseduar paraprakisht certifikatën e autoritetit kompetente që e dëshmon se i plotëson standardet me u përdor në rrugën tonë.

Besa Gaxherri - e kam të qartë se kjo na ka ardhur në mënyrë të ngutshme, dhe në anën tjetër çështja e akcizave është mjaftë komplekse dhe e ndjeshme, por jemi dëshmitar edhe të ngjarjeve që qeveria po punon në politikat fiskale dhe në uljen e taksave në përgjithësi. Sa i përket veturave është e vërtetë se jemi të stërbushur me vjetërsira në të gjitha rrugët tona, por është e vërtetë që populli jonë është i varfër dhe ka nevojë me importue edhe vetura më të vjetra, sepse është mjetë themelor, kështu që nuk duhet të kemi barriera, që të kemi vetura më të vjetra se 13 vjet, dhe një kufizim i tillë nuk ekziston as në rajon. Por anën tjetër, ne duhet ti forcojmë mekanizmat, si është rasti i kontrolleve teknike që përcaktojnë kushtet dhe standardet për një veturë në qarkullim rrugor. Edhe pse duhet ta bëjmë një balancë sepse jemi duke bërë lëvizje të mëdha në politikat fiskale sepse gjithçka nuk mundemi me e ulë, përndryshe, për mendimin tim duhet hequr krejt akcizën për vjetërsinë e veturës. Pajtohem me propozimet dhe janë të mirëseardhura.

Fikrim Damka – pyeti sa do të jetë kostoja për nja paket cigare me këtë rritje?

Lulzim Rafuna- nuk kalkulohet në këtë mënyrë sepse është dëshmuar, se është rritur akciza, nuk është rritur edhe çmimi në tregun e lirë, është psikologjia e tregut që e rregullon ofertën dhe kërkesën.

Bali Muharremaj – ne deri më tani kemi menduar se qeverisja në këtë vit do të fillon me i zbrit taksat dhe akcizën. Ne e dimë që çfarëdo rritje e tatimeve, ndikon në rritjen e çmimeve dhe kjo si rezultat në dëme të taksapaguesve dhe qytetarëve. Për këtë arsyeje jam kundër rritjes të tatimit të akcizës së propozuar.

Kryetari - rritja e akcizës për ne nuk na paraqet problem apo ndonjë shqetësim i madh, po të jemi të përqendruar që ta ruajmë atë shportën e domosdoshme familjare, dhe për këtë jemi më të ndjeshëm, e për çështje tjera te gjitha janë të hapura.

Lulzim Rafuna- në doganë kemi gjithmonë probleme, për arsye se gjatë viteve të shkuara në kohën e UNMIK-ut, në vitin 2008, disa veturat janë regjistruar në mënyra të ndryshme dhe tani po hasim në vetura të pa doganuara. Vetura ka qenë në shfrytëzim me vite dhe tani gjindet se ajo veturë nuk i ka paguar taksat detyruese doganore për arsye të ndryshme, dhe tani pronari po vjen me vullnetin e vetë e unë jam i gatshëm me i pague detyrimet, por ne nuk kemi mundur me zhdoganue veturën sepse ka qenë me e vjetër se 13 vjet. Kjo na mundëson që një fushë prej informalitetit që ka qenë, me e kthye në formalitet.

Enver Hoti – tashmë u tha se na ka ardhur me shpejtësi të madhe ky material, nuk e di arsyen dhe nuk kemi pasur mundësi për analizë. Përkundër mirëkuptimit të pranisë së ministri në takim, unë kërkojë që kjo çështje të mbetet me u trajtue edhe një herë në komision, sepse na nevojitet një angazhim më i gjërë, sepse kemi të bëjmë me çështje që ka të bëjë direkt me qytetarët dhe na duhet një analizë më e thellë dhe një qëndrim pse jo edhe subjektiv.

Avdullah Hoti - ne jemi këtu dhe në çdo detaj mundemi me iu dhënë informacione, ne kemi bërë analiza e caktuar dhe jemi të gatshëm për çdo sqarim, që kjo çështje të kalojë sot.

Kryetari - ne e sqaruam pse ka qenë urgjente me u bë kjo, që mos të krijohen probleme në treg.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit me gjashtë votë Për (Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Besa Gaxherri, Labinote Demi-Murtezi dhe Fikim Damka), një Kundër (Bali Muharremaj) dhe një Abstenim (Enver Hoti), Komisionit nxori këtë

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dt. 24.3.2015 për ndryshimin e normave të akcizës dhe shtimin e listës së mallrave që do të nënshtrohen normës së tatimit të akcizës, në Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

3. Të ndryshme

3.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të Energjisë Elektrike

Kryetari - në mbledhjen e kaluar me rastin e shqyrtimit Rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të Energjisë Elektrike, jemi marrë vesh që të përpilohet raporti me rekomandime dhe të vendosim pastaj si ti drejtohem Kryesisë së Kuvendit. Në vazhdim kryetari i lexoi rekomandimet. Ne nuk mundemi të rekomandojmë që këtë çështje ta shqyrtojë komisioni funksional, pasi që këtë çështje e bënë Kryesia e Kuvendit.

Safete Hadergjona - sa i përket pikës 1, fjalia që është thënë “se nuk mund të ndahen mjete shtesë për këtë qëllim” është pak e vështirë të kuptohet, se kemi të bëjmë me raste sociale. E kemi pikën dy që në një farë mënyre i jep një arsytim kësaj pikës 1, mirëpo edhe nga arsyetimi që është dhënë, por edhe në mungesë të asaj që ligji ende nuk është proceduar në Kuvend, ne nuk mundemi me e ditë se çka përfshin kjo zbritje e TVSH-së për konsumin e energjisë elektrike dhe ne nuk mundemi në arsyetim, ta shkruajmë zbritjen që pritet të ndodhë, ashtu siç ka deklaruar edhe ministri, pasi që ende nuk është proceduar projektligji në Kuvend. Është e vështirë të japim një rekomandim të tillë, që nuk mund të ndahen mjete buxhetore shtesë, me qenë se është fjala për rastet sociale, mirëpo ne duhet ti shohim edhe mundësit buxhetore.

Kryetari - e kam parasysh se nuk ka arrit ligji për ndryshimin e TVSH-së, mirëpo ne kemi informata nga ministri i financave se TVSH do të propozohet të zbritet nga 16 në 8% dhe kjo zbritje ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e pagesës në shpenzimin e energjisë. Kërkesa është e qartë që të ketë rritje të buxhetit nga shuma ekzistuese prej 4.5 milion euro dhe nga ajo që kemi pa gjatë hartimit të buxhetit dhe komunikimit me ministrin e financave, në rishikim nuk do të ketë mundësi të rritjes së buxheti për këtë kategori.

Latif Gashi – mendojë që në rekomandim nuk mund të mbetet fjala “se nuk mund të rritet buxheti për këtë qëllim”. Ne mundemi me konstatue se janë ndarë 4.5 milion euro për kategoritë sociale në emër të pagesës së energjisë, dhe për këto kategori duhet të interesohen edhe institucione tjera si ZRRE dhe ministria e mirëqenies sociale. Unë mendoj se duhet të bëhet një rivlerësim i këtyre kategorive, pajtohem që duhet shteti të kujdeset për kategoritë sociale, mirëpo por nuk jam dakord me e pas njëri në ato lista që nuk kanë nevojë për asistencë sociale.

Besa Gaxherri - është e vërtetë që jemi në një komision shumë profesional na duhet të orientojemi gjithmonë në këtë aspekt. Por ne jemi deputetë edhe përfaqësohem edhe politikisht dhe duhet me pas kujdes në këtë aspekt. Unë pajtohem me propozimin që e tha deputeti para meje, dhe njëkohësisht kërkoj që komisioni funksional që të merret më thellë me këtë problem dhe këtë propozim, i cili ka ardhë nga komisioni për të drejtat e njeriut, sepse është shumë e vërtetë që ne kemi problem me ZRRE-në dhe KEDS-in, dhe na duhet me ba një analizë dhe ndoshta ndonjë auditim, sepse ngritja e çmimit të energjisë elektrike po bëhet pa asnjë problem dhe pa arsyeshmëri.

Safete Hadergjonaj – unë po mendojë që në pikën e parë, të themi se mundësitë buxhetore janë të kufizuara për vitin 2015 për ndarjen e mjete për kategoritë sociale. Si dhe të shtohet edhe një pikë tjetër e rekomandimit ku do të thuhej të rishikohen listat e përfituesve të familjeve në raste social, dhe nëse rishikohen këto lista, jam e bindur se do të zvogëlohet dukshëm numri dhe do të ketë mundësi që të ketë trajtim për kategoritë, që vërtetë janë sociale.

Avdullah Hoti - sqaron se ne vitin 2015 është ndarë shuma prej 4.5 milion euro, për të mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike për familjet me asistencë sociale dhe të pika e parë të thuhet se nuk ka nevojë për mjete shtesë, sepse shuma e ndarë mjafton. Tek pika e dytë mund të shtohet se që zbritja e TVSH-së, të bëhet nga 16% në 8%.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. Me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 janë ndarë 4.5 (katër milion e pesëqind mijë) milion euro, për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, për përfituesit e familjeve në rastet sociale.
- II. Qeveria, në afatin sa më të shpejtë, të procedojë në Kuvend, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin në Vlerën e Shtuar, dhe të propozohet zbritja e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%.
- III. Qeveria, të rishikojë listën e përfituesve të kategorive sociale dhe të identifikohen përfituesit që kanë ndryshuar statusin financiar, në mënyrë që të bëhet rishpërndarja e mjeteve buxhetore, në emër të pagesës së energjisë elektrike, për familjet që ende kanë nevojë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:38

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani